



GJYKIMI BRENDA AFATIT TË ARSYESHËM

(Problemet kushtetuese të Projektligjit aktual)

Autor: Gzim Shala.

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu.

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Sundimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe të National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:



Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Korrik, 2024
Prishtinë, Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

09	1. Përmbledhje ekzekutive
10	2. Qëllimi legjitim
11	3. Kontesti: Pse krijohen vonesat
13	4. Si duhet të adresohet gjykimi brenda një afati të arsyeshëm
14	5. Kriteret e kohëzgjatjes
16	6. Projektligji shkel të drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme
16	7. Diskriminimi i qytetarëve
17	8. Pasojat e Projektligjit në administrimin e drejtësisë
18	9. Përgjegjësia e gjyqtarit
18	10. Kompetenca e Gjykatës Supreme
20	11. Cenimi i te drejtës në mjet juridik
20	12. Efektiviteti i kërkesës për përshpejtim të procedurës
21	13. Afati për përfundimin e procedurës
21	14. Kompensimi i kushtëzuar
22	15. Pamundësia e veprimit
22	16. Gjyqtari shtesë
23	17. Publikimi i vendimit
23	18. Përfshirja e prokurorisë

SHKURTESAT

IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
PROJEKTLIGJI	Projektligji për gjykim brenda afatit të arsyshëm kohor
MD	Ministria e Drejtësisë
MFTP	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
KGjK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
GJTH	Gjykatat Themelore
GJA	Gjykata e Apelit
GJS	Gjykata Supreme
DS	Departamenti Special
AK	Autoriteti Kompetent

1. Përmbledhje ekzekutive

Njëra ndër problemet e vazhdueshme me të cilat përballet sistemi kosovar i drejtësisë është gjykimi në kohë të arsyeshme. Përkundër disa përparimeve të bëra në disa fusha, shkelja e kësaj të drejte të qytetarëve vazhdon të jetë sistematike. Për të adresuar këtë shkelje, Ministria e Drejtësisë ka publikuar për konsultime publike Projektligjin për Realizimin e të Drejtës për Gjykim brenda një Afati të Arsyeshëm Kohor (Tutje: Projektligji). Qëllimin legjitim të synuar përmbajtja e Projektligjit nuk e adreson. Madje, ky Projektligj, me këtë përmbajtje, rrezikon që më tepër të krijoj kaos në sistemin gjyqësor.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut thekson se shtetet kanë për detyrë që të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në atë mënyrë që Gjykatat të mund të përmbushin secilën prej kërkesave të gjykimit të drejtë, ku përfshihet edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm kohor. GjEDNj theksoi se mjetet që duhet zgjedhur, duhet ti përshtaten kontekstit specifik të situatës së Gjyqësorit në një shtet të caktuar. GjEDNj theksoi se është e qartë se për vendet ku ekzistojnë tashmë probleme të kohëzgjatjes së procedurave, një mjet juridik i krijuar për të përshpejtuar procedurat – edhe pse i dëshirueshëm për të ardhmen – mund të mos jetë i përshtatshëm për të korrigjuar një situatë në të cilën procedurat janë tashmë qartazi tepër të gjata. Për këtë arsye, për adresimin e shkeljes brenda një afati të arsyeshëm kohor, shteti duhet të marrë masa të cilat i përshtaten një konteksti specifik. Këtë qasje nuk e ndjek Projektligji. Dispozitat e Projektligjit duket se nuk marrin parasysh kaosin që mund t'a shkaktojnë në praktikë. Kjo duke krijuar probleme si në administrimin e rasteve të cilat vijnë përmes aplikimit të dispozitave të Projektligjit ashtu edhe në administrimin e përgjithshëm të gjykatave.

Projektligji ka përcaktuar afatet kohore të gjykimit, të cilat konsiderohen si afate të arsyeshme: tri vite në shkallë të parë dhe dy vite në shkallë të dytë. Përcaktimi i këtyre afateve si kritere për përlllogaritjen e afatit të arsyeshëm kohor është në kundërshtim të hapur me standardet e vendosura nga GjEDNj në lidhje me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm kohor. GjEDNj ka përcaktuar decidivisht se nuk mund të ketë një kriter uniform lidhur me vlerësimin e arsyeshmërisë së afatit kohor, por kjo duhet vlerësuar rast pas rasti, sipas kriterëve të përcaktuara nga GjEDNj. Pas përcaktimit të afateve kohore, Projektligji i liston kriteret e GjEDNj si kritere përjashtimore, por jo si kritere bazike për vlerësimin e arsyshmërisë së kohëzgjatjes së gjykimit.

Për shkak të këtyre kriterëve, IKD gjenë se është po ky Projektligj që shkel të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, edhe pse synon të kundërtën: nuk do të ketë shkelje të gjykimit në kohë të arsyeshme edhe në rastet kur objektivist, gjykimet mund të realizohen më shpejtë (P.sh. rastet në Departamentin Special) nëse nuk ka kaluar koha e përcaktuar në Projektligj.

Duke mos u fokusuar në fuqizimin e sistemit të drejtësisë për të respektuar gjykimin brenda një afati të arsyeshëm kohor, IKD gjenë se Projektligji krijon diskriminim në mes të qytetarëve që përdorin mjetet juridike sipas Projektligjit përballë qytetarëve që nuk përdorin këto mjete juridike. IKD gjenë rastekur Projektligji garanton të drejtën e mjetit juridik, duke u përfshirë në shkelje kushtetuese.

2. Qëllimi legjitim

Një ndër problemet kryesore të drejtësisë në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë është kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Një kohëzgjatje jo e arsyeshme cenon një prej kompetenteve kyçe të gjyqimit të drejtë, e që është gjykimi brenda një afati të arsyeshëm kohor. Në shumë prej raporteve, IKD vazhdimisht e ka ngritur si shqetësim kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në kontekst të shkeljes së të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor[1]. Edhe Strategjia për Sundimin e Ligjit thekson se “Kohëzgjatja e procedurave mbetet një nga çështjet më kritike dhe komplekse të sektorit të sundimit të ligjit. Ajo ndikon drejtpërdrejtë në të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, siç përcaktohet me Kushtetutë dhe KEDNJ”[2].

Deri tani janë ndërmarrë reforma të rëndësishme për të adresuar këtë problem[3]. Megjithatë, deri më tani, nuk është shënuar progresi i kërkuar. Veçanërisht në fushën civile. Përgjatë përsiatjes institucionale për reforma në këtë fushë, qytetarët kanë vazhduar të presin për drejtësi. E drejta për gjykim në kohë të arsyeshme ka vazhduar të shkelet[4], madje në mënyrë sistematike.

Në vitin 2021, IKD kishte publikuar raportin “Drejtësia e vonuar në Kosovë”. Në këtë raport theksohej se “kohëzgjatja e procedurave gjyqësore mund të trajtohet edhe nga mungesa e një mjeti efektiv juridik i cili do tu ofronte qytetarëve tanë mbrojtjen efektive të së drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme. Në këtë drejtim qytetarët tanë janë të pambrojtur, pasi Republika e Kosovës nuk ka paraparë asnjë mjet i cili do të përdorej nga ta qoftë për të përshpejtuar procesin dhe për të realizuar dëmshpërblim për pasojat e shkaktuara në mos realizimin me kohë të kësaj të drejte”.

Në këtë situatë, qëllimi për të ndërtuar mekanizma që adresojnë këtë shkelje është jashtëzakonisht legjitim. Mekanizma të tilla synojnë mbajtjen përgjegjës të institucioneve për të mbrojtur të drejtat e njeriut, të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare. Por, përtej të gjithave, mekanizmat duhet të jenë adekuat dhe në përputhje me specifikat e kontekstit të Kosovës, me qëllim që të jenë efektiv dhe efikas.

[1] Makshana L; “Amnistimi i Kriminalitetit përmes Parashkrimit”; IKD, Prishtinë, Dhjetor 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/amnistimi-i-kriminalitetit-permes-parashkrimit/>), (Qasur për herë të fundit më 2 Korrik 2024).

Makshana L; “Ndjekja dhe Gjykimi i Korrupsionit 2023”; IKD, Prishtinë, Dhjetor 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/12/NDJEKJA-DHE-GJYKIMI-I-KORRUPSIONIT-2023-Shajp-pdf-2.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 2 korrik 2024).

Zekaj E; “Kompensimi i viktimave të dhunës”; IKD, Prishtinë, Shtator 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/09/KOMPENSIMI-3.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 2 korrik 2024).

Hoxha A; “Hetimet e mangëta dhe Gjykimet e Imëta”; Prishtinë, Shtator 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/09/Raporti-i-Departamentit-te-Pergjithshem-2022-14.09.2023.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 2 korrik 2024).

Bllaca N dhe Mërlaku A; “Drejtësia Civile 2022”; IKD, Prishtinë, Gusht 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtësia-civile-2022/>), (Qasur për herë të fundit më 2 korrik 2024).

Instituti i Kosovës për Drejtësi “Regresi i Drejtësisë Civile”; IKD, Prishtinë, Shtator 2022. (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/09/Raporti_Drejtësia-civile-2021-1.pdf), (Qasur për herë të fundit më 2 korrik 2024).

Thaqi M dhe Nocaq D; “Drejtësia e Vonuar në Kosovë”; IKD, Prishtinë, Dhjetor 2021; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Drejtësia-e-vonuar-ne-Kosove-2021.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 2 korrik 2024).

Frrokaj J dhe Hashani G; “Trajtimi i Vrasjes në Kosovë”; IKD, Prishtinë, Prill 2021; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/trajtimi-i-vrasjeve-ne-kosove/>), Qasur për herë të fundit më 2 korrik 2024).

Shala G; “Praktika e GJEDNJ-së obligim në letër”; IKD, Prishtinë, Shtator 2020; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/09/Praktika-e-GJEDNJ-se-obligim-ne-leter.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 2 korrik 2024).

[2] “Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026”; Ministria e Drejtësisë, Korrik 2021; (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>) - F.11, (Qasur për herë të fundit më 20 qershor 2024).

[3] Po aty.

[4] “Drejtësia e vonuar, drejtësi e mohuar për qytetarët”; Betimi për Drejtësi, 16 Shtator 2024; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtësi-350-drejtësia-e-vonuar-drejtësi-e-mohuar-per-qytetarët/>), (Qasur për herë të fundit më 2 korrik 2024) dhe

“Zvarritjet e drejtësisë për zbardhjen e krimit mbi adoleshentët”; Betimi për Drejtësi, 25 Mars 2023; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtësi-311-zvarritjet-e-drejtësisë-per-zbardhjen-e-krimit-mbi-adoleshentët/>), (Qasur për herë të fundit më 2 korrik 2024);

3. Kontesti: Pse krijohen vonesat

IKD që nga viti 2013 monitoron në mënyrë sistematike rastet gjyqësore në të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës. Përgjatë viteve, IKD mesatarisht brenda një viti ka monitoruar rreth 5.000 seanca gjyqësore në fushën penale, civile, administrative dhe komerciale. Lidhur me kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe faktorët që ndikojnë në këto raste, gjetjet e IKD janë publikuar vazhdimisht në raporte të monitorimit.

Nëse i grupojmë shkaqet, atëherë mund të konkludojmë se shkaqet e shtyrjes së seancave janë objektive, që ndërlidhen me Gjykatat, apo institucionet e tjera, dhe subjektive, që ndërlidhen me efikasitetin e gjyqtarëve, administrimin adekuat të rasteve, sjelljen e palëve etj.

Njëra ndër arsyt kryesore që shkakton vonesa në trajtimin e rasteve gjyqësore është ngarkesa e madhe e gjykatave me lëndë. Kjo është jashtëzakonisht shumë e shprehur në fushën civile. Por, fatkeqësisht, kjo situatë ndër vite ka ardhur vetëm duke u përkeqësuar.

Në raportin mbi drejtësinë civile për vitin 2018, IKD gjente se ka një ulje shumë të vogël të numrit të lëndëve të pazgjidhura. Me këtë tempo, IKD theksonte se drejtësinë civile në Kosovë do t'i duhej kohë e gjatë për t'u stabilizuar. Fatkeqësisht, që nga ajo kohë, ka ndodhur tërësisht e kundërta: numri i lëndëve të pazgjidhura në fushën civile tanimë është dyfishuar^[5].

Në mënyrë kronologjike, që nga viti 2018 e deri në fund të vitit 2022, numri i lëndëve të pazgjidhura është rritur në vazhdimësi, duke rënduar gjendjen e divizioneve civile sa i përket ngarkesës me lëndë. Kjo rritje ka vazhduar deri në fundin e vitit 2023, kur është arritur piku: Në Gjykatat Themelore mbetën 112,623 lëndë të pazgjidhura.

Viti	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Nr. i lëndëve të pazgjidhura	44,213	47,926	64,414	85,087	99.407	112,623

Treguesi nr. 1, Tabela 1: Numri i lëndëve civile të pazgjidhura ndër vite.

“Zvarritjet e drejtësisë për zbardhjen e krimit mbi adoleshentët”; Betimi për Drejtësi, 25 Mars 2023; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-311-zvarritjet-e-drejtesise-per-zbardhjen-e-krimit-mbi-adoleshentet/>), (Qasur për herë të fundit më 2 Korrik 2024).

“Gjykatësi “fle” mbi lëndën e fajdesë”; Betimi për Drejtësi, 26 nëntor 2024; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-296-gjykatesi-fle-mbi-lenden-e-fajdese/>), (Qasur për herë të fundit më 2 Korrik 2024).

“Drejtësia e vonuar”; Betimi për Drejtësi, 5 Dhjetor 2020; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/drejtesia-e-vonuar/>), (Qasur për herë të fundit më 2 Korrik 2024).

“Lëndët në sirtarë të gjykatave”; Betimi për Drejtësi, 12 Shkurt 2020; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/lendet-ne-sirtare-te-gjykatave/>), (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024).

[5] “Drejtësia Civile 2022”; IKD, Gusht 2023; (Shih linkun: [Po aty](#)), F.5-7, (Qasur për herë të fundit më 30 Qershor 2024).

Në trajektoren e ngritjes të numrit të lëndëve të pazgjidhura, rolin primar e ka ngritja eksponenciale e numrit të lëndëve të pranuar.

Viti	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Nr. i lëndëve të pazgjidhura	19,609	21,048	29,319	43,536	40,826	53,767

Treguesi nr. 2, Numri i lëndëve civile të pazgjidhura ndër vite.

Kështu, të paktën gjashtë vitet e fundit, gjendja me numër të lëndëve nuk është përmirësuar, por vetëm është keqësuar. Por, e gjithë kjo situatë, është ndikuar nga faktorë jashtë gjyqësorit. Mos zbatimi i obligimeve të institucioneve publike që rrjedhin nga kontratat kolektive ka detyruar qytetarët që të drejtat e tyre ti realizojnë përmes rrugës gjyqësore. Në vend se institucionet publike të përmbushnin këto obligime, ata kanë detyruar qytetarët që t'i drejtohen Gjykatës. Pos shkeljes së të drejtave të qytetarëve dhe dëmtimit të buxhetit, kjo situatë e ka ngarkuar gjyqësorin deri në këtë situatë.

Në mënyrë të njëjtë Qeveria është duke vazhduar edhe në lidhje me mosnjohjen e pensioneve të dyfishta. Përkundër që Ligji dhe praktika gjyqësore janë të qarta në këtë fushë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk po u'a njej qytetarëve këtë të drejtë. Për këtë arsye, qytetarët detyrohen t'i drejtohen Gjykatës. Pra, edhe kjo situatë ndikon në ngritjen e numrit të lëndëve.[6]

Këto situata, i'a pamundësojnë sistemit gjyqësor që të ofroj drejtësi brenda një afati të arsyeshëm kohor. Përballë një numri kaq të madh të lëndëve, i cili derivon nga mos respektimi i obligimeve që institucionet publike kanë ndaj qytetarëve, gjyqësori e ka të pamundur që të veprojë brenda afateve të arsyeshme.

Përpos ngarkesës me lëndë, gjetjet e monitorimit të IKD-së dëshmojnë edhe shkaktarë të tjerë subjektiv që krijojnë vonesa procedurale. Këtu bënë pjesë mos administrimi adekuat i lëndëve nga ana e gjyqtarëve, që konsiston në mos marrjen e veprimeve procedurale sipas stadeve procedurale të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Shtyrja e seancave gjyqësore, mos dërgimi me rregull i ftesave gjyqësore, pamundësia e dërgimit të ftesave në mënyrë elektronike, vonesat e lëndëve te ekspertët etj janë disa nga problemet të cilat evidentohen në Koncept Dokumentin për Kodin e Procedurës Civile[7].

[6] "Qeveria e Kosovës është duke shkelur të drejtat e pensionistëve për pensionin e dyfishtë"; IKD, 14 Qershor 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/qeveria-e-kosoves-eshte-duke-shkelur-te-drejtat-e-pensionisteve-per-pension-te-dyfishte/>), (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024).

[7] "Koncept dokumenti për Kodin e Procedurës Civile të Kosovës"; Zyra e Kryeministrit, 24 Gusht 2023; (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/08/KD-per-KPC-per-publikim-shq.pdf>), faqe 26, (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024).

4. Si duhet të adresohet gjykimi brenda një afati të arsyeshëm

GjEDNj thekson se në terma absolut, pa diskutim, adresimi më adekuat i shkeljes së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor është parandalimi. Kjo Gjykatë thekson se shtetet kanë për detyrë që të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në atë mënyrë që Gjykatat të mund të përmbushin secilën prej kërkesave të gjykimit të drejtë, ku përfshihet edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm kohor. GjEDNj po ashtu thekson se aty ku sistemi gjyqësor është i mangët në këtë drejtim, zgjidhja më efektive është një mjet juridik i krijuar për të përshpejtuar procedurat në mënyrë që të parandalohen që ato të zgjasin tepër.[8]

Megjithatë, vet GjEDNj theksoi se mjetet që duhet zgjedhur, duhet ti përshtaten kontekstit specifik të situatës së Gjyqësorit në një shtet të caktuar. GjEDNj theksoi se është e qartë se për vendet ku ekzistojnë tashmë probleme të kohëzgjatjes së procedurave, një mjet juridik i krijuar për të përshpejtuar procedurat – edhe pse i dëshirueshëm për të ardhmen – mund të mos jetë i përshtatshëm për të korrigjuar një situatë në të cilën procedurat janë tashmë qartazi tepër të gjata. Ky qëndrim i GjEDNj u mbrojt në disa raste.[9]

Për këtë arsye, për adresimin e shkeljes brenda një afati të arsyeshëm kohor, shteti duhet të marrë masa të cilat i përshtaten një konteksti specifik. Thënë më ndryshe, masat të cilat janë marrë nga shtetet të cilat nuk e kanë shumë të theksuar këtë problem, nuk mund të ndërmerren në sistemet ku shkelja e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor është pothuajse standard dhe koha e gjyqësorëve është tepër e gjatë.

Në këtë situatë, para se të përcaktohen mjete juridike të cilat e detyrojnë gjyqësorin që të respektojë këtë të drejtë, është e rëndësishme që gjyqësori të fuqizohet deri në atë pikë sa ka mundësi, të paktën objektive, ta respektojë këtë të drejtë. Në të kundërtën, rrezikohet situata kur gjyqësori do të shkelë edhe një të drejtë tjetër, atë të garantuar sipas Projektligjit që është objekt i këtij dokumenti.

Kështu, para së gjithash, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ndërmarrë masa për ta kthyer gjyqësorin në binarë. Kuptohet, masat në asnjë rrethanë nuk duhet të tejkalojnë kompetencat e Qeverisë dhe të ndërhyjnë në punën e institucioneve të sistemit të drejtësisë.

[8] Vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “Case of Scordino v. Italy (No. 1)”, Paragrafi 183; Strasbourg, 29 Mars 2006; (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-72925%22%5D%7D>), (Qasur për herë të fundit 29 qershor 2024).

[9] Po aty, Paragrafi 185 dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: “Case of Tomazic v. Slovenia (Application no. 38350/02)”, Paragrafi 37; Strasbourg, 13 Dhjetor 2007; (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appid%22:%5B%2238350/02%22%5D%2C%22itemid%22:%5B%22001-83973%22%5D%7D>); “Case of Finger v. Bulgaria (Application no. 37346/05)”, Paragrafi 127; Strasbourg, 10 Maj 2011; (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-104698%22%5D%7D>); “Case of Robert Lesjak v. Slovenia (Application no. 33946/03)”, Paragrafi 36; Strasbourg, 21 Korrik 2009; (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appid%22:%5B%2233946/03%22%5D%2C%22itemid%22:%5B%22001-93660%22%5D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024).

Ajo çfarë kërkohet të bëjë Qeveria është që fillimisht të ndërmarrë masa që institucionet të zbatojnë obligimet që kanë. Zbatimi i këtyre obligimeve do t'ua ulte numrin e lëndëve gjyqësore dhe gjyqësori do të kishte mundësi të trajtonte rastet më shpejt. Tutje, duhet fuqizuar edhe Mekanizmat për Zgjidhjen Alternative të Lëndëve, në mënyrë që një numër i konsiderueshëm i lëndëve të zgjidhen nëpërmjet këtyre mekanizmave dhe jo nga Gjykata. Vetëm në këtë situatë, kur gjyqësori të ishte objektivisht i gatshëm për të respektuar të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, atëherë mund të ndërtohen mekanizma të cilat plotësojnë hapësirat brenda sistemit gjyqësor, në rastet përjashtuese kur shkelet e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Por, këto masa, janë të presupozuara që të dështojnë në një sistem ku shkelja e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor është parim.

Kështu, siç e ka theksuar edhe GjEDNj, masa të tilla nuk janë adekuate në sistemet ku kohëzgjatja e procedurave është tepër e gjatë. Analiza e mëposhtme jep detaje shtesë të kësaj situatë, që dëshmon se Projektligji më tepër do të krijoj kaos në sistemin gjyqësor se sa adresim të kësaj situatë.

5. Kriteret e kohëzgjatjes

Neni 5 i Projektligjit ka përcaktuar se “1. Afate të arsyeshme të përfundimit të procedurës gjyqësore në gjykatat e Republikës së Kosovës, për qëllimet e këtij ligji do të konsiderohen: 1.1. Në gjykimin në shkallën e parë, përfundimi i procesit të gjykimit brenda tre (3) viteve nga fillimi i tij; 1.2. Në gjykimin në shkallë të dytë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy (2) viteve nga fillimi i tij, dhe 1.3. Në hetimin e veprave penale vlen afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve sipas Kodit të Procedurës Penale”.

Përcaktimi i këtyre afateve si kritere për përllogaritjen e afatit të arsyeshëm kohor është në kundërshtim të hapur me standardet e vendosura nga GjEDNj në lidhje me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm kohor.

GjEDNj ka përcaktuar decidivisht se nuk mund të ketë një kriter uniform lidhur me vlerësimin e arsyeshmërisë së afatit kohor. Kjo Gjykatë ka nënvizuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së një procedure gjyqësore duhet të vlerësohet në secilin rast, sipas rrethanave të veçanta, sipas kritereve të përcaktuara nga GjEDNj.[10]

GjEDNj ka përcaktuar se kriteret për vlerësimin e arsyeshmërisë kohore në secilin rast, janë kompleksiteti i rastit[11] sjellja e palës...

[10] Vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: “Case of Comingersoll S.A. v. Portugal (Application no. 35382/97)”, Paragrafi 19; Strasbourg 6 Prill 2000; (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-58562%22%7D%7D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 30 Qershor 2024).

[11] Vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: “Case of Katte Klitsche de la Grange v. Italy”, Paragrafi 55; Strasbourg; (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57893%22%7D%7D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 30 Qershor 2024); “Case of Humen v. Poland (Application no. 26614/95)”, Paragrafi 39; Strasbourg, 15 Tetor 1999; (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-58322%22%7D%7D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024).

6. Projektligji shkel të drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme

Përballë qëllimit legjitim të Projektligjit që i njëjti të parandaloj dhe të adresoj shkeljen e të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, IKD gjen se është po ky Projektligj që bëhet shkaktar i shkeljes së kësaj të drejte. Në nenin 5 të Projektligjit janë përcaktuar afatet kohore të trajtimit të rasteve, brenda të cilit afat, konsiderohet se rastet janë trajtuar brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Mirëpo, afatet e përcaktuara nga ky Ligj nuk mund të konsiderohen afate të arsyeshme kohore. Sipas këtij Ligji, që nga inicimi i një rasti në Gjykatë, duhet të kalojnë pesë vite deri në plotfuqishmërinë e një aktgjykimi (tri në shkallë të parë dhe dy në shkallë të dytë), për tu konsideruar se gjykimi është bërë brenda një afati të arsyeshëm kohor. Nëse i shohim afatet ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore apo Kodin Nr. 08/L-032 e Procedurës Penale, afatet janë shumë më të shkurta. Në këtë situatë, ulet edhe synimi për gjyqësorin: Gjyqësori nuk do ta ketë synim që rastet ti trajtojë brenda afateve të përcaktuara në Ligje, por, pa marrë parasysh specifikat, rastet t'i zgjidhë brenda pesë viteve. Në vështrim të përgjithshëm, pesë vite për trajtimin e një rasti nuk konsiderohet afat i arsyeshëm kohor.

Në anën tjetër, në disa departamente, gjyqësori ka avancuar konsiderueshëm sa i përket trajtimit të rasteve. Marrim shembull Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Departamentin Special të Gjykatës së Apelit. Nëse kemi para vetëm një aktakuzë të ngritur nga ana e PSRK, ndaj 1 të pandehuri, për 1 vepër penale, i cili ka pranuar fajësinë, dhe rasti është trajtuar nga shkalla e parë për 2 vite e 11 muaj, sipas Projektligjit, nuk kemi të bëjmë me shkelje të gjyqësorit brenda një afati të arsyeshëm kohor. Por, në bazë të kriterëve të GjEDNj, hipotetikiisht, në këtë situatë qartazi do kishim të bënim me shkelje të gjyqësorit brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Për këtë arsye, kriteret e vendosura nga Projektligji që synon mbrojtjen e gjyqësorit brenda një afati të arsyeshëm kohor janë pikërisht arsye e shkeljes së kësaj të drejte.

7. Diskriminimi i qytetarëve

Siç u elaborua në këtë dokument, në rastin e Kosovës, shkelja e gjyqësorit brenda një afati të arsyeshëm kohor është një dukuri e shprehur në masë. Për këtë arsye, kërkohen veprime sistematike, për ta fuqizuar gjyqësorin me mundësinë që i njëjti të ketë mundësi të trajtoj rastet brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Mirëpo, në këtë situatë, nëse adresimi i shkeljes së të drejtës së qytetarëve për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor kufizohet vetëm sipas dispozitave të këtij Projektligji, atëherë do të krijohet ana tjetër e shkeljes, e që është diskriminimi i qytetarëve të cilët nuk përdorin mjetet juridike sipas Projektligjit.

Kështu, nëse dy qytetarëve do tu shkelet e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe vetëm njëri prej tyre përdor mjetet juridike sipas Projektligjit, atëherë vetëm njërit prej tyre do ti adresohet kjo shkelje dhe jo edhe personit që nuk ka aplikuar mjetet juridike sipas Projektligjit. Ndërsa, e drejta duhet tu takojë të dyve dhe institucionet duhet të kujdesen që t'ua mbrojnë këtë të drejtë të gjithë qytetarëve.

Në anën tjetër, në po të njëjtët situatë, është pikërisht Projektligji i cili paraqet potencial për ngritjen e trajtimit të pabarabartë të palëve. Marrim shembull një rast kur një qytetar është duke pritur për më tepër se tri (3) vite në shkallë të parë për të marrë drejtësi, i drejtohet Kryetarit të Gjykatës me kërkesë për përshpejtim të procedurës. Pasi plotësohen kriteret sipas këtij Ligji dhe Kryetari i Gjykatës në përputhje me nenin 13 të Projektligjit vendos të pranoj kërkesën për përshpejtim të procedurës dhe të përcaktoj një afat kohor për zgjidhjen e çështjes gjyqësore, atëherë Gjykata duhet ta trajtoj këtë rast brenda afateve të përcaktuara në vendimin e Kryetarit të Gjykatës. Por, kjo urgjencë, mund të reflektohet me pamundësi të Gjyqarit që të trajtoj një rast tjetër, më të vjetër se rasti konkret. Kjo për faktin e vetëm se në rastin e parë, qytetari ka përdorur mjetet juridike sipas Projektligjit ndërsa në rastin e dytë jo.

8. Pasojat e Projektligjit në administrimin e drejtësisë

Dispozitat e Projektligjit duket se nuk marrin parasysh kaosin që mund t'a shkaktojnë në praktikë. Kjo duke krijuar probleme si në administrimin e rasteve të cilat vijnë përmes aplikimit të dispozitave të Projektligjit ashtu edhe në administrimin e përgjithshëm të gjykatave.

Fillimisht, për shkak të shpeshtësisë së shkeljes së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor, ekziston një potencial i lartë që gjykatat të vërshohen nga numri i madh i kërkesave për përshpejtim të procedurës.

Lidhur me kërkesën për përshpejtim të procedurës, Kryetari i Gjykatës ka dy stade procedurale për të vendosur: Pranueshmërinë e kërkesës sipas nenit 11 të Projektligjit dhe vendimin lidhur me kërkesën për përshpejtim të procedurës sipas nenit 13 të Projektligjit. Kësaj të fundit, duhet t'i paraprijë procedura sipas nenit 12 të Projektligjit. Në kuadër të kësaj procedure, Kryetari i Gjykatës duhet ti drejtohet gjyqarit, kryetarit të trupit gjykues ose prokurorit që t'i paraqesin një raport brenda 10 ditëve lidhur me kërkesën e palës për përshpejtim të procedurës [neni 12.1 i Projektligjit]. Po ashtu, "Kryetari i gjykatës mund të kërkoj nga gjyqari ose trupi gjykues t'i dorëzohet edhe dosja e lëndës" [neni 12.3. i Projektligjit].

Nëse Kryetarët e Gjykatave vërshohen nga një numër i madh i kërkesave për përshpejtim të procedurës, atëherë Kryetari i Gjykatës, së bashku me një gjyqar shtesë, nuk do të kenë mundësi të trajtojnë këto raste brenda afateve të përcaktuara me këtë Projektligj. Kjo situatë do të sjellë shkeljen tjetër ndaj qytetarëve, atë të trajtimit të kërkesave sipas Projektligjit brenda një afati të arsyeshëm.

Për më tepër, kjo ngarkesë e Kryetarit të Gjykatës, rrezikon që Kryetari i Gjykatës mos të ketë mundësi t'i përmbushë obligimet e tij për administrimin e Gjykatës. Kjo më pastaj do të krijoj pasoja zingjirore në administrimin e drejtësisë në të gjitha Gjykatat.

Për më tepër, deri në trajtimin e rasteve nga ana e Kryetarit të Gjykatës, rrezikohet të cenohet edhe efikasiteti në trajtimin e rasteve, kjo për shkak se gjyqtarët duhet që me kërkesë të Kryetarit të Gjykatës, të dorëzojnë dosjen tek Kryetari i Gjykatës. Krahas cenimit të administrimit të rasteve, edhe barra administrative për këtë proces do të jetë shumë e madhe. Kjo situatë, do të cenoj në mënyrë të konsiderueshme administrimin adekuat të drejtësisë brenda gjykatave.

Për këtë arsye, IKD i rekomandon MD që të rishqyrtojë dispozitat e projektligjit, veçanërisht sa i përket kompetencës dhe procedurës, në kuptim të mënyrës se si të njëjtat ndikojnë në administrimin e drejtësisë.

9. Përgjegjësia e gjyqtarit

Neni 8.1. i Projektligjit ka përcaktuar se “Në rastet e dështimit të gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës të veprimit në mënyrën dhe brenda afateve të parapara me këtë ligj përbën bazë për inicim të procedurës disiplinore në pajtim me legjislacionin përkatës për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve”.

Sipas këtij neni, gjyqtari mund të mbahet përgjegjës edhe pa fajin e tij. Kjo pasi në rastin konkret, Projektligji nuk i referohet fajit të gjyqtarit, por thjesht “dështimit” për të vepruar brenda afateve të përcaktuara me këtë ligj. Mund të ketë situata, kur gjyqtari ka “dështuar” për të trajtuar rastet brenda afateve të përcaktuara me ligj. Por, ka mundësi që ky “dështim” të ketë ardhur si rezultat i rrethanave objektive, psh. tej ngarkesës së tij me lëndë, kompleksitetit të çështjes, mos përgjigjes adekuate nga ana e institucioneve të tjera etj. Përkundër kësaj, kjo dispozitë e Projektligjit e mban përgjegjës gjyqtarin, duke mos paraparë nevojën për hulumtimin mbi nivelin e fajit të gjyqtarit, përkatësisht për të trajtuar nëse i njëjti ka “dështuar” për shkak të neglizhencës, keqadministrimit etj. apo për shkaqe objektive.

Andaj, IKD i rekomandon MD që të rishqyrtojë nenin 8 të Projektligjit.

10. Kompetenca e Gjykatës Supreme

Neni 19 i Projektligjit përcakton se “1. Për të vendosur mbi padinë për kompensim të drejtë të dëmit lidhur me shkeljen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshem kohor kompetente është Gjykata Supreme 2. Gjykata Supreme vendos në panel prej tre (3) gjyqtarësh”. Trajtimi i këtyre rasteve nga ana e Gjykatës Supreme rrezikon që ta shkatërroj Gjykatën Supreme. Për më tepër, vendosja nga ana e Gjykatës Supreme si shkallë e parë, cenon të drejtën e qytetarëve në mjet juridik.

Aktualisht, nga të gjitha Gjykatat, po thuhet vetëm Gjykata Supreme ka një stabilitet me lëndë. Në fillim të vitit 2013, kjo Gjykatë ka pasur në punë 202 lëndë. Nga 1860 lëndë të pranuar, kjo Gjykata ka arritur të zgjidhë 1860 prej tyre, duke lënë për periudhën pasuese vetëm 214 lëndë[16]. Nëse kompetenca për trajtimin e padive për kompensim të dëmit për shkak të shkeljes së të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor i lihet Gjykatës Supreme, atëherë kjo Gjykatë do të vërshohet nga numri i madh i lëndëve. Në këtë situatë, Gjykatës Supreme do ti shkatërrohet stabiliteti i arritur, duke i pamundësuar kësaj Gjykate ushtrimin e kompetencave bazike që ajo ka.

Në anën tjetër, Ligji Nr. 06/L - 054 për Gjykata [neni 26] ka përcaktuar kompetencat bazike të Gjykatës Supreme. Në rastin konkret, vendosja në shkallë të parë, nuk është në kuadër të natyrës së Gjykatës Supreme, si Gjykata më e lartë. Këtu, e kemi parasysh se dispozita në fjalë e Ligjit për Gjykata ndryshohet me një ligj tjetër. Por, prap se prap, duhet ruajtur karakteri që ka një Gjykatë Supreme.

Tutje, vendosja e Gjykatës Supreme si gjykatë e shkallës së parë cenon të drejtën e qytetarëve në mjet juridik. Projektligji nuk ka përcaktuar asnjë mjet juridik dhe as të jashtëzakonshëm ndaj vendimit të Gjykatës Supreme. Neni 32 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka përcaktuar se “Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”. Mungesa e një mjeti juridik në rastin konkret paraqet shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Sa i përket mundësisë për iniciimin e rastit në Gjykatën Kushtetuese, duhet theksuar se mundësia e ngritjes së një rasti të tillë sipas nenit 113.7. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk paraqet mjet juridik adekuat. Qytetarëve duhet tu mundësohet një mjet juridik brenda për brenda gjyqësorit, para se rasti të shkojë në Gjykatën Kushtetuese.

Megjithatë, palët prapë do të kenë të drejtë të ankohen në Gjykatën Kushtetuese. Kjo situatë rrezikon edhe vërshimin e Gjykatës Kushtetuese me ankesa të cilat derivojnë nga dispozitat e këtij Ligji. Kështu, pos Gjykatës Supreme, lënia e këtyre rasteve në kompetencë të Gjykatës Supreme rrezikon edhe administrimin e Gjykatës Kushtetuese.

Për këto arsye, IKD i propozon MD që të rishikojë dispozitat që kanë të bëjnë me kompetencën për trajtimin e padive për kompensim të dëmit për shkak të shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Në këtë rast, duhet të shqyrtohet ose mundësia e ndërtimit të ndonjë trupe të veçantë gjyqësore ose mundësia e krijimit të ndonjë mekanizmi administrativ brenda gjyqësorit, siç është rasti i Panelit për Lirim me Kusht apo Komisionit për Kompensimin e dëmit për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye.

[16] “Raporti Statistikor i Gjykatave, Vjetori 2023”; Këshilli Gjyqësor i Kosovës; (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/1682_KGJK_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Vjetori_2023.pdf), f. 3, (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024).

11. Cenimi i te drejtës në mjet juridik

Neni 11 i Projektligjit ka përcaktuar dispozitat që kanë të bëjnë me pranueshmërinë e kërkesës për përshejtim të procedurës. Paragrafi 4 i këtij neni përcakton se “Kryetari i gjykatës vendos mbi pranueshmërinë e kërkesës për përshejtim të procedurës gjyqësore brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës”. Por, paragrafi pasues i këtij neni përcakton se “Kundër këtij vendimit nuk lejohet ankesë”.

Kështu, sipas nenit 11 të Projektligjit, nëse Kryetari i Gjykatës në mënyrë arbitrare vendos ta shpallë një rast të papranueshëm, ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankesë. Kjo dispozitë është në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që përcakton se “Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

Andaj, neni 11.5. i Projektligjit është në kundërshtim me Kushtetutën. Për këtë arsye, IKD i rekomandon MD që të rishikojë këtë dispozitë në kuptim të garantimit të mjetit juridik, e drejtë kjo e garantuar me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

12. Efektiviteti i kërkesës për përshejtim të procedurës

Kërkesa për përshejtim të procedurës supozohet të jetë një mjet që adreson shkeljen e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor. Nëse shohim edhe dispozitat e nenit 13 të Projektligjit, shihet se përmes këtij mjeti supozohet të nxjerrët një vendim nga ana e Kryetarit të Gjykatës që konstaton shkelje të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe caktim të një afati kohor për përfundimin e lëndës.

Qëllimi i kërkesës për përshejtim të procedurës cenohet nga neni 12.4. i Projektligjit, që përcakton se “Në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës për përshejtim të procedurës gjykata apo prokuroria që po kryen veprimet, ndërmerr hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pushon shqyrtimi i kërkesës”. Kjo normë cenon parashikueshmërinë e këtij mjeti juridik. Në secilin rast, interes i qytetarit është vlerësimi i arsyeshmërisë kohore të trajtimit të një rasti dhe në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, caktimin e një afati përfundimtar për zgjidhjen e rastit gjyqësor. Por, e gjithë kjo rrezikohet nga neni 12.4. i Projektligjit.

Në momentin kur paraqitet një kërkesë për përshejtimin e procedurës, gjyqtari përkatës ka mundësi të ndërmarrë një veprim procedural dhe në bazë të këtij neni, ta ndalë procedurën e trajtimit të kërkesës për përshejtim të procedurës.

Kështu, ndërmarrja e një veprimi procedural mundëson pushimin e procedurës së trajtimit të kërkesës për përshpejtim të procedurës, por nuk mundëson zgjidhje të rastit brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Për këtë arsye, IKD rekomandon që neni 12.4. i Projektligjit të fshihet.

13. Afati për përfundimin e procedurës

Neni 13.3. i Projektligjit përcakton se “Kryetari i gjykatës merr vendim për pranimin e kërkesës për përshpejtim të procedurës dhe mund t’i jap gjyqtarit ose trupit gjykues një afat kohor prej jo më tepër se 120 ditë për përfundimin e procedurës gjyqësore”. Edhe në këtë rast, Projektligji zgjedh që të caktojë periudhë specifike kohore, por jo të lejoj mundësinë e përshtatjes kohore.

Fillimisht, është pozitive fakti se Ligji ka tavanin maksimal, duke lejuar që në raste specifike, afati të jetë më i shkurtër. P.sh. nëse përfundimi i rastit varet edhe vetëm nga një seancë, atëherë Projektligji lejon mundësinë që afati të jetë më i shkurtër se 120 ditë.

Megjithatë, Projektligji nuk përcakton situatat praktike që mund të lindin, kur afati prej 120 ditëve nuk është i mjaftueshëm. Në praktikë shfaqen situata kur për përfundimin e rasteve nevojitet kohë më e gjatë. P.sh. në rastet kur kemi të bëjmë me dhjetëra persona të akuzuar apo qindra dëshmitarë, është e paarsyeshme të kërkohet nga gjyqtari përfundimi i rastit brenda afatit prej 120 ditëve. Në këto raste, përcaktimi i afatit prej 120 ditëve për zgjidhjen e rastit është i presupozuar që mos të zbatohet në praktikë.

Për këtë arsye, IKD i rekomandon MD që ta rishqyrtojë afatin e përcaktuar në nenin 13.3. të Projektligjit.

14. Kompensimi i kushtëzuar

Në kuptim të nenit 17.2. të Projektligjit, qytetarët nuk mund të parashtrojnë padi për kompensimin e dëmit nëse paraprakisht nuk kanë paraqitur kërkesë për përshpejtimin e procedurës. Megjithatë, duhet theksuar se nëse një rast nuk trajtohet brenda një afati të arsyeshëm kohor, shkelja ka ndodhur. Qytetarit i është mohuar kjo e drejtë kushtetuese, edhe nëse paraprakisht i njëjti nuk ka kërkuar përshpejtimin e procedurës.

Për këtë arsye, kushtëzimi procedural për kompensimin e dëmit për shkak të shkeljes së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor, me kërkesën për përshpejtimin e procedurës, lë të amnistuara rastet kur kjo e drejtë është shkelur, por qytetari nuk ka kërkuar përshpejtim të procedurës.

Kompensimi për shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor por si kompensim për qytetarin, duhet të shërbejë edhe si mjet i mbajtjes llogaridhënës së gjyqësorit për mos respektim të kësaj të drejte. Andaj, është e paarsyeshme mbrojtja e gjyqësorit nga këto padi përmes pengesës procedurale të përcaktuar në nenin 17.2. të Projektligjit.

Për këtë arsye, IKD rekomandon fshirjen e nenit 17.2. të Projektligjit.

15. Pamundësia e veprimit

Neni 14.1. i Projektligjit ka përcaktuar se “Kryetari i gjykatës nuk mund të vendos lidhur me kërkesën për përshpejtim të procedurës nëse më parë është marrë me atë çështje në cilësinë e gjyqtarit”. Ndërkaq, paragrafi 3 i të njëjtit nen ka përcaktuar se “Nëse as Kryetari i Gjykatës Supreme nuk mund të veprojë sipas paragrafit 1 të këtij neni, për kërkesën vendos një kolegji prej tre gjyqtarëve të Gjykatës Supreme”.

Kolegji prej tre gjyqtarëve të Gjykatës Supreme nuk mund të konsiderohet zgjidhje adekuate për këtë situatë. Kjo pasi të tre gjyqtarët e Gjykatës Supreme në këtë rast janë vartës të Kryetarit të kësaj Gjykate. Kjo zgjidhje, sikurse nuk është aplikuar në raport me Kryetarin e Gjykatës Themelore, nuk mund të aplikohet as në raport me Kryetarin e Gjykatës Supreme.

Për këtë situatë, IKD rekomandon zgjidhjen analoge sikurse tek Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ku si autoritet kompetent për shkeljet e supozuara të Kryetarit të Gjykatës Supreme paraqitet Këshilli Gjyqësor i Kosovës[17].

Andaj, IKD i rekomandon MD rishikimin e kësaj dispozite.

16. Gjyqtari shtesë

Neni 11.2. i Projektligjit ka përcaktuar se “Në gjykatat me më shumë se dhjetë (10) gjyqtarë, një gjyqtar shtesë mund të caktohet nga kryetari që përveç tij të vendos lidhur me kërkesat për përshpejtim të procedurës”.

Kushtëzimi i caktimit të gjyqtarit shtesë me “dhjetë (10) gjyqtarë” duket se është i pa objekt. Nuk ka asnjë Gjykatë në Kosovë që ka më pak se 10 gjyqtarë. Për këtë arsye, kjo mundësi jepet në secilin rast. Ka raste kur degët e Gjykatave Themelore kanë më pak se 10 gjyqtarë. Por, të njëjtat janë degë të Gjykatave dhe jo Gjykata. Të njëjtat po ashtu nuk kanë Kryetarë të Gjykatave, por gjyqtarë mbikëqyrës.

[17] Ligji I Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, neni 9.1.1.3.

17. Publikimi i vendimit

Neni 18.2. i Projektligjit përcakton se “Krahas kompensimit monetar, pala ka të drejtë të kërkoj nga gjykata, tek e cila është parashtruar kërkesa për përshejtim të procedurës, që të publikoj vendimin me të cilin është konstatuar shkelja e së drejtës në gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor”. Publikimi i vendimit përmes kërkesës së palës nuk paraqet standard adekuat.

Njëri ndër parimet e Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike [neni 4.2.] është se “qasja në dokumente publike bëhet përmes publikimit proaktiv nga ana e institucioneve publike të dokumenteve publike dhe përmes kërkesës së personit për qasje në dokumente publike”. Ndërkaq, Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale në nenin 370 ka përcaktuar dispozitat që kanë të bëjnë me publikimin e vendimeve gjyqësore, derisa urdhri për publikimin e aktgjykimit listohet edhe dënim plotësues[18].

Këto dispozita të cituara nuk kanë ndonjë ndërlidhje me rastin konkret. Megjithatë, këto tregojnë natyrën e dispozitave që kanë të bëjnë me publikimin e dokumenteve publike. Dispozita të tilla duhet ti referohen institucionit dhe të ndjekin një qëllim legjitim: p.sh. transparencën. Por, dispozitat që kanë të bëjnë me publikimin e vendimeve nga institucioni, nuk duhet kategorizuar si të drejta të palëve. Palët kanë mundësi që vet të publikojnë vendimet që pranojnë. Këtë mund ta bëjnë në platforma të ndryshme dhe jo përmes institucionit.

Për këtë arsye, IKD rekomandon që të shqyrtohet mundësia e vendosjes së dispozitave të përgjithshme, që të publikohen të gjitha vendimet dhe jo që për publikimin e vendimeve, gjyqësori t’i shërbejë palës vetëm si platformë publikimi.

18. Përfshirja e prokurorisë

Neni 5 i Projektligjit ka përcaktuar se “Afate të arsyeshme të përfundimit të procedurës gjyqësore në gjykatat e Republikës së Kosovës, për qëllimet e këtij ligji do të konsiderohen: 1.3. Në hetimin e veprave penale vlen afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve sipas Kodit të Procedurës Penale”. Çështja e hetimit, nuk bënë pjesë në kuadër “gjykimin”, përfundimi brenda një kohe të arsyeshme i së cilit është objekt i këtij Projektligji. Për këtë arsye, përfshirja e fazës hetimore në këtë Projektligj del jashtë objektit që ka Projektligji.

Për këto arsye, IKD rekomandon që neni 5.1.1.3. i Projektligjit të fshihet dhe kjo të reflektohet edhe në nenet e tjera të Projektligjit, si p.sh. neni 12, neni 15.3. etj. të Projektligjit.

Raporti "Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm", (Problemet kushtetuese të Projektligjit aktual), është realizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi me mbështetjen e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Sundimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe të National Endowment for Democracy (NED).



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD